



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**Programi
Gratë,
Paqja dhe
Siguria**

SHQETËSIMET LIDHUR ME SIGURINË E GRAVE NË KOSOVË



Shkurt 2024



Autorë: Adelina Hasani dhe Vesa Kroçi

Rreth Programit Gjinia, Paqja dhe Siguria


Programi Gjinia, Paqja dhe Siguria është zhvilluar për të mbështetur progresin e Kosovës në arritjen e objektivave të përcaktuara në agjendën e Gruas, Paqes dhe Sigurisë. Në përputhje me Rezolutën 1325, Programi Gjinia, Paqja dhe Siguria i QKSS-së synon të mbështesë institucionet e sigurisë publike në Kosovë në krijimin e politikave të përgjegjshme gjinore të brendshme dhe të jashtme. Ndër të tjera, programi synon të sigurojë pjesëmarrje të barabartë gjinore në institucionet kryesore të sigurisë së Kosovës si Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policia e Kosovës (PK). Për më tepër, ai synon të konsolidojë një gjerësi të hulumtimit që identifikon sfidat kryesore që lidhen me reformën e sigurisë në aspektin gjinor në Kosovë. Përmes ofrimit të analizave gjinore për zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë, programi synon të promovojë reformën e brendshme në përputhje me parimet e barazisë gjinore të vendit të përcaktuara në Ligjin për Barazi Gjinore. Programi do të zhvillohet më tej përmes:

- *Avokimit qendror dhe lokal për të identifikuar sfidat kryesore që lidhen me pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë;*
- *Monitorimit fillestar, i mesëm dhe i fundit i rekrutimit brenda institucioneve të sigurisë publike në Kosovë;*
- *Analizave gjinore në përputhje me objektivat e WPS të Kosovës.*

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni ne:

GenderProgram@qkss.org

Përkrahur nga:





QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

SHQETËSIMET LIDHUR ME SIGURINË E GRAVE NË KOSOVË

Shkurt 2024

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
HYRJE	2
Metodologjia	3
KORNIZA LIGJORE, POLITIKE DHE INSTITUCIONALE NË KOSOVË	4
SFIDAT NË ADRESIMIN E SHQETËSIMEVE TË SIGURISË SË GRAVE NË KOSOVË	6
REKOMANDIMET	12

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dhuna në bazë gjinore paraqet një kërcënim të madh të sigurisë për gratë dhe vajzat në Kosovë, siç dëshmohet nga numri në rritje i dhunës në bazë gjinore dhe vrasjeve të grave në vitet e fundit. Pavarësisht rritjes së dukshme të rasteve të raportuara të dhunës në familje gjatë viteve të fundit në Kosovë, numri i rasteve të pa raportuara të dhunës në bazë gjinore mbetet i lartë për shkak të faktorëve kompleksë socio-ekonomikë që kontribuojnë në këtë fenomen.

Besimi i grave në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë është kritik për raportimin e dhunës në bazë gjinore. Megjithatë, butësia e sistemit gjyqësor ndaj autorëve dhe stërzgjatja e rasteve të dhunës në familje i dekurajon gratë të kërkojnë drejtësi. Ka mungesë të ndjeshmërisë dhe ekspertizës në mesin e autoriteteve të zbatimit të ligjit, veçanërisht në zonat rurale, për të trajtuar në mënyrë efektive rastet e dhunës në bazë gjinore.

Mungesa e trashëgimisë pronësore tek gratë është një pengesë e rëndësishme për pavarësinë dhe sigurinë e tyre ekonomike. Përkundër dispozitave ligjore për të drejta të barabarta pronësore, gratë shpesh heqin dorë nga trashëgimia e tyre, duke i lënë ato me burime dhe mundësi të kufizuara kur përballen me dhunën. Kjo mungesë e autonomisë financiare i lë gratë në një situatë shqetësuese ku ato mund të ndihen të detyruara të kthehen te abuzuesit e tyre.

Shumë gra tërheqin ankesat e tyre për dhunën në bazë gjinore për shkak të ndërhyrjeve të palëve të treta, shpesh nën presionin e familjes. Ka një tendencë në mesin e anëtarëve të familjes dhe zyrtarëve për të fajësuar gratë për raportimin e abuzimit, gjë që i dekurajon edhe më shumë ato që të kërkojnë ndihmë. Gratë që raportojnë dhunën në familje shpesh përjetojnë diskriminim të dyfishtë nga institucionet, shoqëria dhe familjet e tyre.

Ka informacion të kufizuar për të drejtat dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e dhunës në bazë gjinore në Kosovë. Mungesa e ndërgjegjësimit intensifikon ndjenjat e cenueshmërisë dhe përkeqëson ndjenjën e pafuqisë kur kërkon zgjidhje. Ka gjithashtu investime të pamjaftueshme në shërbimet mbështetëse për viktimat dhe në pasojat për autorët e veprave.

Financimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm për strehimoret përbën një sfidë të rëndësishme për mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje. Pa burime adekuate, strehimoret bëjnë orvatje maksimale për të i ruajtur shërbimet thelbësore dhe për të i përmbushur kërkesat në rritje për shërbimet e tyre. Ekziston gjithashtu një mungesë e mbështetjes së qëndrueshme institucionale për viktimat, duke bërë që disa të kthehen te abuzuesit e tyre.

HYRJE

Hulumtimi analizon shqetësimet kryesore të sigurisë me të cilat përballen gratë dhe vajzat, duke vlerësuar aftësitë e mekanizmave të sigurisë, si në nivelin lokal edhe atë qendror për t'u përgjigjur çështjes së ngritur të sigurisë së grave. Një aspekt tjetër i studimit përfshin vlerësimin e ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me pasojat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Për më tepër, ai vlerëson efektivitetin e mekanizmave joformalë të sigurisë në nivelin lokal dhe angazhimin e komunitetit në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.

Dhunë në familje nënkupton “të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimë.”¹ Dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore mund të marrin forma të ndryshme diskriminimi; Kosova është përballur me shumë raste tragjike të dhunës në bazë gjinore që kanë përfunduar me femicid. Rastet e Diana Kastratit, Valbona Markut, Sebahate Morinës, Diana Kastratit, Antigona Morinës, Dafina Zhubit, Zejnepe Berishës janë raste të njohura për opinionin në Kosovë, të cilat janë vrarë nga partnerët e tyre.

Dhuna në bazë gjinore paraqet një kërcënim të dukshëm të sigurisë për gratë dhe vajzat në Kosovë, siç dëshmohet nga numri në rritje i dhunës në bazë gjinore dhe vrasjeve të grave në vitet e fundit. Shumica e të mbijetuarave, të cilat janë kryesisht gra dhe vajza që përjetojnë dhunë në familje, përballen me mungesën e mbështetjes së qëndrueshme në nivel institucional. Kjo mungesë e mbështetjes institucionale, së bashku me qasjen e kritikuar institucionale patriarkale dhe trajtimin e rasteve të tilla, ka shkaktuar dënime nga organizatat dhe aktivistët e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në vitet e fundit, protesta të organizuara janë mbajtur në mbarë Kosovën si përgjigje ndaj dhunës me bazë gjinore dhe femicideve, duke adresuar në mënyrë specifike numrin alarmues të femicideve.²

Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur në mënyrë të vazhdueshme, nga 1,915 raste në vitin 2019 në pak më shumë se 2,000 në vitin 2020 dhe në mbi 2,400 në vitin 2021 dhe mbi 2,700 në vitin 2022.³ Numrat ka të ngjarë të jenë më të ulëta se numri i rasteve aktuale të dhunës në familje, për shkak se shumë të mbijetuara zgjedhin të mos raportojnë abuzimin tek autoritetet.⁴

Edhe pse numri i raportimeve të dhunës në familje pasqyron rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore në Kosovë, ka gjithashtu dëshmi të mungesës së kapaciteteve institucionale për të parandaluar dhunën me bazë gjinore. Për më tepër, rastet e raportuara shpesh

1 Konventa e Stambollit, neni 3(b).

2 “Tri Dekada Protestat”, Kosovo 2.0, <https://kosovotwopointzero.com/en/three-decades-protest/> (i qasshëm).

3 “Ndani përvojën tuaj: Dhuna në Familje në Kosovë”, Balkan Insight, <https://balkaninsight.com/2023/03/13/share-your-experience-domestic-violence-in-kosovo/#:~:text=The%20number%20of%20cases%20of,of%20the%20victims%20being%20women> (i qasshëm).

4 “Nga letra në praktikë: Kosova duhet të mbajë zotimet e saj ndaj të mbijetuarve të dhunës në familje”, Amnesty International, 2023, fq.16.

prezantohen me një qasje të fajësimit të viktimave, nga mendësitë e rrënjësura thellë brenda strukturës patriarkale të shoqërisë. Serioziteti i kësaj situatë intensifikohet duke marrë parasysh shkallën e ulët të punësimit të grave dhe pavarësinë e kufizuar financiare të tyre.

Edhe pse ekzistojnë shumë sfida institucionale dhe sociale në parandalimin e dhunës në bazë gjinore, nga ana tjetër, qeveria aktuale ka vënë në pah luftën kundër dhunës me bazë gjinore si një prioritet kombëtar. Në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e politikave për parandalimin e dhunës ndaj grave, janë marrë disa masa institucionale. Këto masa synojnë të arrijnë një koordinim afatgjatë në parandalimin e dhunës ndaj grave, më konkretisht përmes: (i) funksionalizimit të Grupit Ndërmatoror për Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026; (ii) krijimit të Mekanizmave Koordinues Lokal; (iii) përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive të Mekanizmave Koordinues Komunal përmes Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore; (iv) përkufizimi i Procedurave Standarde të Operimit.⁵

Metodologjia:

Hulumtimi bazohet në hulumtimin në zyrë, duke u thelluar në kuadrin ekzistues ligjor, politik dhe institucional që trajton dhunën në bazë gjinore, si dhe hulumtimet në terren.

QKSS ka organizuar një sërë diskutimesh në fokus grupe në 29 komuna, duke përfshirë Skenderajn, Gjilanin, Vushtrinë, Kaçanikun, Shtërpçën, Istogun, Lipjanin, Obiliqin, Malishevën, Prishtinën, Prizrenin, Vitinë, Kllokotin, Gjakovën, Suharekën, Rahovecin, Fushë Kosovën, Drenasin, Dragashin, Klinën, Mitrovicën, Mitrovicën e Veriut, Hani e Elezit, Shtimen, Kamenicën, Podujevën, Pejën, Mamushën dhe Ferizajin. Pjesëmarrësit në këto fokus grupe përfshijnë akterë kryesorë të përfshirë në parandalimin e dhunës në bazë gjinore, si shoqatat e grave, punonjësit socialë dhe institucionet e sigurisë. Diskutimet në fokus grupeve synonin të siguronin një pasqyrë më të thellë mbi përhapjen e dhunës në bazë gjinore, të dallojnë qëndrimet e komunitetit, të nxjerrin në pah sfidat në qasjen institucionale dhe potencialisht të zbulonin trendet sipas komunave.

Përveç kësaj, janë kryer gjashtë intervista me përfaqësues nga shtatë strehimore për të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë. Gjithashtu janë zhvilluar dy intervista me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. QKSS e ndërmori këtë iniciativë gjithëpërfshirëse hulumtuuese nga marsi 2022 deri në shkurt 2024.

⁵ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022- 2026, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf> (e qasshme).

KORNIZA LIGJORE, POLITIKE DHE INSTITUCIONALE NË KOSOVË

Kosova ka zhvilluar një kornizë të avancuar ligjore, politike dhe institucionale për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Zbatimi efektiv i kësaj kornize ka potencialin për të transformuar në mënyrë domethënëse përpjekjet për të luftuar dhunën me bazë gjinore në Kosovë. Megjithatë, Kosova vazhdon të përballet me shumë sfida në zbatimin e plotë të infrastrukturës së saj ligjore dhe institucionale që synon parandalimin e dhunës në bazë gjinore.

Sipas nenit 22 të Kushtetutës, të gjitha traktatet ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Kjo dispozitë përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me instrumentet e OKB-së dhe KE-së e që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë dhe kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Ato përfshijnë si vijon: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grua; Konventa për të Drejtat e Fëmijë; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.⁶

Në vitin 2020, Kosova ndërmori një hap të rëndësishëm duke miratuar një amendament kushtetues që i dha efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Stambollit – një traktat madhor për të drejtat e njeriut që përcakton standarde ligjore gjithëpërfshirëse për të mbrojtur të drejtën e grave për të jetuar të lirë pa dhunë.⁷ Më pas, në vitin 2022, Kosova e përmirësoi edhe më tej angazhimin e saj duke prezantuar **Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave për vitet 2022-2026**. Në veçanti, Strategjia e re jo vetëm që e shtrin qëllimin e saj përtej paraardhësve të saj, por gjithashtu përafron zbatimin e masave të ndjeshme gjinore me parimet e përshkruara në Konventën e Stambollit.⁸

Ligji Nr. 05/L – 020 për Barazinë Gjinore i cili u miratua në vitin 2004 dhe më pas u amendamentua në vitin 2015, garanton, mbron dhe promovon barazinë ndërmjet gjinive si vlerë bazë e zhvillimit demokratik të shoqërisë.⁹ Në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Barazi Gjinore, Qeveria ka miratuar **Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore - Zyra e Kryeministrit**. Ky dokument strategjik bazohet në një

6 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

7 Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), <https://www.coe.int/en/web/gender-matters/council-of-europe-convention-on-preventing-and-combating-violence-against-women-and-domestic-violence> (e qasshme).

8 "Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave," <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf> (e qasshme).

9 "Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore", Kuvendi i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923> (e qasshme).

analizë të situatës të kryer përmes një procesi gjithëpërfshirës hartimi që përfshin organizata joqeveritare si dhe partnerë vendas dhe ndërkombëtarë. Programi përbëhet nga tre shtylla: (i) fuqizimin ekonomik dhe mirëqenien sociale; (ii) zhvillimi njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore; dhe (iii) të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria.¹⁰

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, ngacmimin seksual dhe gjymtimin gjenital të femrave i kategorizon si vepra penale. Përveç kësaj, ligji trajton veprat penale kundër integritetit seksual duke përcaktuar pëlqimin. Sipas ligjit, pëlqimi përkufizohet si pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) ose më të vjetër për t'u përfshirë në një akt të caktuar seksual. Ai gjithashtu përfshin marrëveshjen vullnetare të dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmëdhjetë (14) vjeç e lart, dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, për të kryer aktin seksual në fjalë.¹¹

Në vitin 2023, Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Qëllimi i këtij ligji është të parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në bazë gjinore, të mbrojë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, të promovojë barazinë gjinore dhe të fuqizojë gratë. Ai synon gjithashtu krijimin e mekanizmave të nevojshëm për të ofruar mbështetje për viktimat e të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj.¹² BE-ja gjithashtu përshëndeti miratimin e ligjit dhe bëri thirrje për zbatimin e shpejtë të ligjit në përputhje me Kodin Penal dhe Konventën e Stambollit.¹³

Institucionet dhe ofruesit e shërbimeve të Kosovës janë të obliguar të parandalojnë dhunën në bazë gjinore dhe të ofrojnë mbështetje për të mbijetuarit. Në kuadër të këtyre subjekteve përfshihen Policia e Kosovës, Prokuroritë, Gjykatat, Koordinatori i Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje/Zëvendës Ministri i Ministrisë së Drejtësisë, Qendrat për Punë Sociale, Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë e Viktimave/Avokatët e Viktimave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ Drejtoritë e Arsimit, Shkollat, Avokati i Popullit/Departamenti për Barazi Gjinore, Strehimoret dhe Shoqëria Civile.¹⁴

10 Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, Zyra e Kryeministrit, <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf> (e qasshme).

11 “Kodi nr. 06/ L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës” Kuvendi i Republikës së Kosovës, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf> (e qasshme).

12 Ligji nr. 08/L – 185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Bazë Gjinore, Kuvendi i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=83131> (e qasshme).

13 BE-ja në Kosovë mirëpret miratimin e Ligjit për dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë Përfaqësues Special të Bashkimit Evropian në Kosovë, https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu-kosovo-welcomes-adoption-law-domestic-violence-gender-based-violence-and-violence-against-women_en?s=321 (e qasshme).

14 “Raportimi mbi Dhunën në Familje”, OSBE, 2018, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/404348.pdf> (e qasshme).

SFIDAT NË ADRESIMIN E SHQETËSIMEVE TË SIGURISË SË GRAVE NË KOSOVË

Dhuna në bazë gjinore paraqet një kërcënim të dukshëm të sigurisë për gratë dhe vajzat në Kosovë, siç dëshmohet nga numri në rritje i dhunës në bazë gjinore dhe vrasjeve të grave në vitet e fundit. Rastet e paraportuara paraqesin një sfidë të rëndësishme për të kuptuar shtrirjen e plotë të dhunës në familje përkundër se ka rritje të dukshme të rasteve të raportuara të dhunës në familje gjatë viteve të fundit në Kosovë, ky hulumtim hedh dritë mbi vazhdimësinë alarmante të rasteve të paraportuara të dhunës në bazë gjinore, duke theksuar veçanërisht faktorë të ndërlikuar socio-ekonomikë që kontribuojnë në këtë fenomen. Ngurrimi për të raportuar dhunën në bazë gjinore është i shumanshëm, duke përfshirë pafuqinë ekonomike, stigmën sociale dhe mungesën e besimit në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë. Megjithatë, besimi në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë shfaqet si një faktor kritik që ndikon në vendimin për të raportuar dhunën në bazë gjinore. E drejta e pronësisë, një aspekt thelbësor i pavarësisë ekonomike të grave, shfaqet si një tjetër shqetësim urgjent. Pavarësisht kornizave ligjore që garantojnë të drejta të barabarta pronësore, realiteti zbulon një hendek të madh midis dispozitave ligjore dhe rezultateve praktike.

Narrativa mbizotëruese patriarkale brenda institucioneve synon të normalizojë një dhunë të tillë, duke penguar përparimin drejt një qasjeje të ndjeshme gjinore. Tërheqja e ankesave për shkak të ndërhyrjeve të palëve të treta, shpesh të nxitura nga presionet familjare, i shton një shtresë tjetër sfidës, duke e mbajtur të gjallë diskriminimin e dyfishtë ndaj grave që raportojnë dhunën në familje. Informacioni i kufizuar në lidhje me të drejtat dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e përkeqëson problemin. Përkundër rritjes së ndërgjegjësimit për raportimin e dhunës me bazë gjinore, ka investime të pamjaftueshme në shërbimet mbështetëse dhe në pasoja për autorët e veprave. Mungesa e opsioneve të trajtimit për shkelësit recidivistë në incidentet e dhunës në familje përbën një pengesë qendrore, duke theksuar nevojën për strategji efektive për rehabilitimin dhe pengimin e përsëritësve të shkeljeve.

Përgjatë hulumtimit tonë, ne kemi identifikuar sfidat kryesore që rrjedhin nga nivelet institucionale, ekonomike, politike dhe ligjore që pengojnë përpjekjet për të garantuar sigurinë e grave në Kosovë. Këto sfida përshkruhen në seksionet e mëposhtme.

Rastet e paraportuara të dhunës në bazë gjinore. Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur në mënyrë të vazhdueshme, nga 1,915 raste në vitin 2019 në pak më shumë se 2,000 në vitin 2020 dhe në mbi 2,400 në vitin 2021 dhe mbi 2,700 në vitin 2022.¹⁵ Ky studim zbuloi se ka ende rastet e paraportuara të dhunës me bazë gjinore, ku një pjesë e konsiderueshme që përfshin dhunën në familje shpesh kalon pa u vënë re. Siç edhe deklaroi një grua gjatë një fokus grupi: ‘Duhet pasur guxim për të raportuar dhunën

¹⁵ Ndani përvojën tuaj: Dhuna në Familje në Kosovë”, Balkan Insight, <https://balkaninsight.com/2023/03/13/share-your-experience-domestic-violence-in-kosovo/#:~:text=The%20number%20of%20cases%20of,of%20the%20victims%20being%20women> (i qasshëm).

në bazë gjinore, duke pasur parasysh mungesën e mbështetjes institucionale që marrin gratë.”¹⁶ Ky raportim i pamjaftueshëm i atribuohet kryesisht pafuqizimit ekonomik dhe social të grave, i shoqëruar nga mbështetja e pamjaftueshme e shtetit për viktimat e dhunës në familje. Rastet që raportohen prirën të lindin kur viktimat nuk shohin ndonjë alternativë tjetër të mundshme për të kërkuar ndihmë.¹⁷ Gjatë fokus grupit në Klinë, një pjesëmarrës deklaroi: “Kur një grua vendos të raportojë rastin, kuni parasysh se në fakt është rast i përsëritur; rasti i parë nuk raportohet kurrë; duhet pak kohë derisa vendosin të e raportojnë. Kur gratë vendosin të raportojnë, nënkupton se ato kanë vuajtur për një kohë të gjatë.”¹⁸ Për më tepër, shkeljet e konfidencialitetit kanë ndikuar negativisht në raportimin e dhunës me bazë gjinore, pasi reporterët e mediave shkelin parimet e konfidencialitetit, duke cenuar integritetin e të mbijetuarave.¹⁹ ²⁰ Frika për të qenë subjekt i gjykimit nga miqtë, fqinjët apo edhe anëtarët e familjes shpesh i pengon gratë të raportojnë abuzimin. Shumë gra zgjedhin të qëndrojnë të heshtura për përjetimet e tyre për shkak të stigmës së përhapur që lidhet me të qenit viktimë të abuzimit. Kjo stigmë mund të shkaktojë ndjenja turpi, faji dhe sikleti, duke i penguar më tej gratë të kërkojnë ndihmë ose të flasin. Kultura e fajësimit të viktimës dhe e gjykimit përjetëson një cikël të dëmshëm heshtjeje, kjo u jep abuzuesve lirinë për të vazhduar me abuzime.

Besimi në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë. Dënimet ligjore të dhëna nga gjykatat, së bashku me kohëzgjatjen e tepërt të rasteve të dhunës në familje, i dekurajojnë gratë që të raportojnë dhunën në bazë gjinore. Gjatë fokus grupit në komunën e Klinës, një pjesëmarrës deklaroi: “Një nga arsyet pse ata nuk raportojnë është mungesa e besimit tek institucionet. Gratë u besojnë institucioneve të policisë e sigurisë, por nuk u besojnë institucioneve të drejtësisë. Ky mosbesim lind për shkak të dënimeve shumë të buta për autorët e dhunës dhe procedurave të stërzgjatura.”²¹ Shqyrtimi sistematik nga ana Amnesty International i vendimeve gjyqësore kundër 218 të pandehurve zbuloi se 74 për qind morën dënim me burg të kushtëzuar, 45 për qind morën një gjobë dhe 20 për qind morën një gjobë të pezulluar. Disa të pandehur morën një kombinim dënimesh, si dënim me burg me kusht dhe gjobë.²² Përveç dënimit të butë të autorëve të dhunës me bazë gjinore, mbledhja e provave në vendin e krimit është një nga sfidat kryesore në luftimin e dhunës me bazë gjinore.²³

Nga ana tjetër, vonesat në rastet e divorcit ose kujdestarisë së fëmijëve mund t’i detyrojnë të mbijetuarit të ribashkohen me partnerët e tyre abuzues.²⁴ Për më tepër, në shumë komuna rurale, gratë mund të hezitojnë të raportojnë raste të dhunës në bazë gjinore, ndërkohë që autoriteteve të zbatimit të ligjit shpesh u mungon ekspertiza e nevojshme për të trajtuar

16 Diskutim në fokus grup në komunën e Gjakovës, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

17 Diskutim në fokus grup në komunën e Gjakovës, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

18 Diskutim në fokus grup në komunën e Klinës, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

19 Diskutim në fokus grup në komunën e Klokotit, 31 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

20 Diskutim në fokus grup në komunën e Drenasit, 16 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

21 Diskutim në fokus grup në komunën e Vitisë, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

22 ‘Nga letra në praktikë: Kosova duhet të mbajë zotimet e saj ndaj të mbijetuarve të dhunës në familje’, Amnesty International, 2023.

23 Intervistë me një përfaqësuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, shkurt 2024.

24 Intervistë e QKSS me Përfaqësuesin e Strehimores për Viktimat e Dhunës në Familje në Pejë, Qershor, 2022.

siç duhet raste të tilla. Një pjesëmarrës nga diskutimi në fokus grup në komunën e Kllokotit përmendi “Policia nuk kishte njohuri të duhura për procedimin e një rasti të dhunës në familje.”²⁵

Mungesa e drejtës së pronësisë së grave tërheq vëmendjen si një shqetësim urgjent. E drejta e pronësisë është shumë e rëndësishme sepse mund të lehtësojë qasjen në mbrojtje ligjore dhe shërbime mbështetëse, duke u mundësuar grave të mbrojnë të drejtat e tyre dhe të kërkojnë ndihmë pa frikë nga zhvendosja ose hakmarrja. Një pjesëmarrëse nga strehimorja e Gjakovës deklaroi “Çështja e pronësisë dhe trashëgimisë është një problem i madh, sepse edhe kur u ofrohet trashëgimi grave, ato e refuzojnë dhe ua japin si dhuratë vëllezërve të tyre dhe më pas në rast dhune nuk kanë ku të shkojnë”.²⁶ Hulumtimi vë në pah mungesën e trashëgimisë në pronë si një pengesë kryesore që pengon pavarësinë ekonomike të grave. Kjo pamjaftueshmëri jo vetëm që kufizon autonominë financiare, por gjithashtu kontribuon në një model shqetësues ku gratë mund të ndjehen të detyruara të kthehen te abuzuesit e tyre, të durojnë dhunën dhe të mos e raportojnë atë. Pavarësisht kornizës ligjore të Kosovës që garanton të drejta të barabarta pronësore për të dyja gjinitë, realiteti i zyrtarë zbulon se vetëm 19 për qind e pronave janë në pronësi të grave, deklaroi Kryeshefi Ekzekutiv të Agjencisë për Barazi Gjinore.²⁷ Kjo pabarazi e madhe midis dispozitave ligjore dhe rezultateve praktike thekson nevojën urgjente për iniciativa që mbrojnë dhe zbatojnë pronësinë e barabartë të pronës, duke siguruar që gratë të kenë mjetet për të arritur autonominë ekonomike dhe për t’u çliruar nga situatat abuzive. Po ashtu, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2022, shkalla më e lartë e punësimit ishte te meshkujt me 50.8 për qind, krahasuar me femrat, shkalla e punësimit të të cilave ishte 19.1 për qind.²⁸ Kjo komplikon më tej nënshtrimin dhe diskriminimin e shumëanshëm me të cilin përballen gratë në Kosovë, duke kontribuar në brishtësinë e sigurisë së tyre. Adresimi i këtyre sfidave të ndërlidhura është imperativ për nxitjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave ekonomisht dhe socialisht.

Mungesa e ndjeshmërisë gjinore në nivel institucional: Hulumtimi ka zbuluar se institucioneve në Kosovë u mungon një qasje e ndjeshme gjinore në trajtimin e rasteve të dhunës në bazë gjinore. Ekziston një boshllëk në kuptimin e tyre gjithëpërfshirës të dinamikës së ndërlidhur që lidhet me gjininë, e cila përfshin një dështim për të njohur mosbalancimet e pushtetit, normat shoqërore dhe stereotipet që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore. Narrativa mbizotëruese patriarkale vazhdon të minimizojë dhe normalizojë dhunën me bazë gjinore, duke përjetësuar pozitën nënshtruese të grave në shoqëri. Gjatë takimit të fokus grupit në Fushë Kosovë me akterët institucionalë dhe anëtarët e Shoqërisë Civile, një pjesëmarrës deklaroi: “Jemi dëshmitarë të rasteve kur policët – të cilët duhet të jenë mbrojtësit kryesorë kundër dhunës gjinore – tentojnë ta bëjnë si normale atë duke thënë si zakonisht: “nuk bëhet nami prej një flakareshe”. Normalizimi i dhunës është i përhapur në diskutimet me aktorët institucionalë, ku argumentet sugjerojnë se raportimi i dhunës po bëhet trend. Kjo është

25 Diskutim në fokus grup në komunën e Kllokotit, 31 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

26 Intervistë me përfaqësues të strehimores së Gjakovës, 2 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

27 <https://balkaninsight.com/2023/03/09/kosovo-women-still-struggling-to-win-property-rights/#:~:text=Kosovo's%20legal%20framework%20gives%20equal,for%20Gender%20Equality%2C%20Edi%20Gusia>

28 Anketa lidhur me Fuqinë Punëtore (AFP) për tremujorin e tretë (TM3) të 2022, <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/6380> (e qasshme)

veçanërisht evidente sepse raportimi i dhunës seksuale përfshin gjithashtu raste të dhunës ekonomike dhe psikologjike, siç përmendet në Konventën e Stambollit.²⁹

Tërheqja e ankesës për dhunë në bazë gjinore. Shpesh, me ndërhyrjen e palëve të treta për të pajtuar gratë viktime të dhunës me dhunuesit e tyre (në shumicën e rasteve, partnerët e tyre abuzues), gratë tërheqin ankesën për dhunë në bazë gjinore. Kjo ndodh nën presionin që vjen nga anëtarët e familjes.³⁰ Hulumtimi zbuloi se fokusimi në pajtimin e anëtarëve të familjes në rastet e dhunës në familje ka filluar të bëhet procedurë e zakonshme, edhe pse nuk është e zbatueshme për të gjitha rastet. Megjithatë, ka raste kur gratë përballen me situatë e fajësohen edhe nga anëtarët e familjes e edhe zyrtarët për raportimin e dhunës në familje. Një pjesëmarrëse në fokus grupin e mbajtur në komunën e Vitisë e përmendi situatën: “Kam dëgjuar një polic që i thotë një gruajë viktimë: ‘A nuk të vjen turp ta raportosh burrin tënd dhe ta dërgosh në burg?’”³¹ Familja e gruas e cila raporton dhunën në familje rrallëherë e mbështet vendimin e saj për t’i shpëtuar abuzimit dhe për t’u larguar nga burri dhunues dhe përpiqet ta bindë atë të kthehet te burri dhunues i cili në shumë raste është recidivist.³² Gratë që raportojnë dhunën në familje vazhdojnë të vuajnë diskriminim të dyfishtë, qoftë nga institucionet, shoqëria apo familjet e tyre. Kjo shërben si një tregues tjetër që pengon gratë të raportojnë raste të dhunës në familje. Një pjesëmarrës gjatë fokus grupit të mbajtur në Rahovec deklaroi: “Ka edhe raste, ku për shkak të mungesës së mbështetjes së qëndrueshme institucionale ndaj viktimave, ato u janë kthyer dhunuesve të tyre për shkak të fëmijëve të tyre.”³³

Ende ka informacione të kufizuara në lidhje me të drejtat e tyre dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës në bazë gjinore. Megjithëse që ka një rritje të ndërgjegjësimit për raportimin e dhunës me bazë gjinore, ka investime të pamjaftueshme si në mbështetjen që mund të marrin viktimat ashtu edhe në pasojat me të cilat mund të përballen autorët për aktet e tyre abuzive. Kuptimi i kufizuar i sistemeve mbështetëse të disponueshme mund të intensifikojë ndjenjat e cenueshmërisë dhe të përkeqësojë ndjenjën e pafuqisë kur kërkoni zgjidhje. Për të mbyllur këtë boshllëk informacioni kërkohen përpjekje të koordinuara për të përmirësuar programet e informimit, për të rritur ndërgjegjësimin përmes fushatave dhe për të thjeshtuar qasjen në burime. Ka raste kur gratë që përballen me dhunë në familje nuk janë të informuara për ekzistencën e strehimoreve.³⁴ Një pjesëmarrëse në fokus grupin në komunën e Rahovecit deklaroi, “Qytetarët duhet të informohen për pasojat juridike, duhet të ketë një paralajmërim të qartë se ata që kryejnë dhunë në familje dënohen me burgim për disa vite, dhe e njëjta vlen edhe për recidivistët.”³⁵

29 Konventa e Stambollit, neni 3/b8.

30 Diskutim në fokus grup në komunën e Suharekës, 3 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

31 Diskutim në fokus grup në komunën e Vitisë, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

32 Diskutim në fokus grup në komunën e Podujevës, 7 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

33 Diskutim në fokus grup në komunën e Rahovecit, 8 nëntor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

34 Diskutim në fokus grup në komunën e Ferizajt, 11 dhjetor 2023. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

35 Diskutim në fokus grup në komunën e Ferizajt, 11 dhjetor 2023. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Mungesa e trajtimit për recidivistët. Një pjesë e konsiderueshme e incidenteve të dhunës në familje përfshijnë individë me një histori të shkeljeve të përsëritura, duke paraqitur një pengesë qendrore për trajtimin efektiv të rasteve të tilla. Në kontekstin e dhunës në familje, vërehet se shumë raste përfshijnë individë të cilët në mënyrë të përsëritur përfshihen në akte të dhunshme brenda një rrethi familjar. Vazhdimi i recidivizmit në këto raste mund t'i atribuohet mungesës së opsioneve të qëndrueshme të trajtimit institucional për autorët e veprave.³⁶ Një pjesëmarrëse në fokus grupin në Klinë e përmendi përhapjen e recidivizmit, duke theksuar se “Kur një grua vendos të raportojë një rast, ka të ngjarë të jetë viktimë e një situatë recidiviste sepse dhuna rrallë raportohet menjëherë në rastin e parë. Kjo nënkupton që gratë shpesh durojnë vuajtje të zgjatura përpara se të zgjedhin të raportojnë dhunën në polici.”³⁷ Në mënyrë të ngjashme, një përfaqësues nga Strehimorja për viktimat e dhunës në familje në Ferizaj theksoi natyrën e përsëritur të çështjes, duke deklaruar, “Ne kemi raste kur e mbijetuara largohet nga strehimorja dhe kthehet më vonë pasi ka përjetuar dhunë prapë”. Një sfidë e rëndësishme lind nga pamjaftueshmëria e trajtimit të përshtatshëm ose masave të ndërhyrjes për këta autorë recidivista. Për më tepër, shumica e rasteve të recidivizmit ndodhin si rezultat i strehimoreve që ofrojnë shërbime vetëm gjashtë muaj. Zgjidhja dhe parandalimi i rasteve recidiviste të dhunës në familje kërkon zhvillimin e strategjive efektive për të rehabilituar dhe parandaluar individët me një histori të kryerjes së dhunës brenda mjediseve familjare.

Mungesa e personelit policor të gjinisë femëroeshtë një tregues i rëndësishëm i raportimit të pamjaftueshëm të dhunës me bazë gjinore. Gjatë hulumtimit tonë, kemi konstatuar se në komunën e Dragashit, nuk ka fare zyrtare policore të angazhuar aty, siç u theksua gjatë takimit që zhvilluam. Kjo mangësi shihet si një pengesë e rëndësishme për nxitjen e besimit tek institucionet për raportimin e incidenteve të dhunës në familje.³⁸ Përfshirja aktive e grave në institucionet kyçe të sigurisë si Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës (PK), Agjencia e Inteligjencës së Kosovës (AKI) dhe mekanizma të tjerë relevantë të sigurisë shihet si një hap pozitiv. Kjo rrit mundësitë për parandalimin e rasteve të dhunës në familje dhe komunitete. Përfshirja më e gjerë e grave në role të ndryshme brenda strukturave të sigurisë jo vetëm që promovon barazinë gjinore, por gjithashtu forcon efektivitetin e përgjithshëm të këtyre institucioneve në adresimin dhe parandalimin e dhunës në bazë gjinore.³⁹ Publikimi i fundit i QKSS me temën “Perceptimi i grave police për integrimin gjinor në Policinë e Kosovës” dhe “Integrimi gjinor në Forcën e Sigurisë në Kosovë” thekson ndikimin e rëndësishëm të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë. Ky përfshirje jo vetëm që përmirëson performancën e grave në sektorin e sigurisë, por gjithashtu nxit besimin e shtuar midis grave për të raportuar raste të dhunës me bazë gjinore.

Financimi dhe shërbimet e pamjaftueshme dhe të paqëndrueshme për të mbijetuarat e dhunës në familje, veçanërisht për strehimoret, përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për

36 Diskutim në fokus grup në komunën e Podujevës, 7 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

37 Diskutim në fokus grup në komunën e Klinës, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

38 Diskutim në fokus grup në komunën e Dragashit, 26 tetor 2023. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

39 Diskutim në fokus grup në komunën e Rahovecit, 8 nëntor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

reagimin institucional. Financimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm për strehimoret përbën një sfidë të rëndësishme për trajtimin e dhunës në familje dhe mbështetjen efektive të të mbijetuarave. Financimi i kufizuar rrezikon aftësinë e strehimoreve për të mbajtur shërbimet thelbësore. Pa resurse adekuate, strehimoret orvaten për të përmbushur kërkesën në rritje për shërbimet e tyre, duke lënë shumë të mbijetuara pa ndihmën që u nevojitet urgjentisht. Siç thotë drejtuesja e një strehimoreje në Gjakovë, “Financat janë problemi kryesor me të cilin përballemi. Ne marrim fonde të vogla nga donatorët ndërkombëtarë, por ata nuk japin mjete financiare për ushqim, veshmbathje dhe materiale bazë që na duhen në strehimore, sepse konsiderojnë se shteti duhet të merret me këtë punë përmes politikave sociale për njerëzit që nuk kanë mundësi.”⁴⁰ Për më tepër, një pjesëmarrëse në diskutimin e fokus grupeve në Gjilan deklaroi: “Në mungesë të shërbimeve hasim raste të përsëritura; viktimat strehohen për një kohë të shkurtër, por mungon vazhdimësia. Për rrjedhojë, dhuna përshkallëzohet dhe përsëritet. Sipas Konventës së Stambollit, ne jemi të obliguar të vazhdojmë të mbrojmë viktimat edhe pas përfundimit të qëndrimit të tyre në strehimore.”⁴¹ Pjesëmarrësit e shërbimeve sociale në fokus grupet ndajnë gjithashtu një shqetësim të përbashkët për mungesën e fondeve adekuate për të ofruar trajtim optimal për rastet e dhunës me bazë gjinore. Mbështetja e kufizuar në dispozicion për gratë i detyron ato të kthehen te abuzuesit e tyre, duke shkaktuar nivele të larta të dhunës.⁴²

40 Intervistë me drejtuesin e një strehimoreje në Gjakovë, 2 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

41 Diskutim në fokus grup në komunën e Gjilanit, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

42 Diskutim në fokus grup në komunën e Gjilanit, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

REKOMANDIMET

1. Zbatimi i iniciativave për fuqizimin ekonomik të grave, duke përfshirë zbatimin e të drejtave pronësore dhe promovimin e mundësive të barabarta të punësimit për të fuqizuar gratë ekonomikisht.

2. Fushata avokuese drejt nxjerrjes në pah të shërbimeve të disponueshme për rastet e dhunës në bazë gjinore. Hulumtimet ekzistuese tregojnë se fushatat e mëparshme kryesisht u përqendruan në rritjen e ndërgjegjësimit për raportimin e dhunës në bazë gjinore dhe jo në rritjen e ndërgjegjësimit për mbështetjen dhe shërbimet thelbësore që u ofrohen viktimave të dhunës me bazë gjinore.

3. Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese që dekurajojnë në mënyrë aktive ndërhyrjet e palëve të treta që synojnë të detyrojnë gratë të tërheqin ankesat ose të pajtohen me partnerët abuzues kundër vullnetit të tyre. Këto udhëzime duhet të theksojnë rëndësinë e fuqizimit të të mbijetuarave për të marrë vendime të pavarura dhe të nxjerrin në pah pasojat negative të ndërhyrjeve të tilla, duke synuar krijimin e një mjedisi mbështetës që respekton veprimin dhe autonominë e të mbijetuarave në rastet e dhunës në bazë gjinore.

4. Rritja e përfaqësimit të grave në institucionet kryesore të sigurisë, duke përfshirë forcën policore, për të nxitur besimin dhe për të rritur ndjeshmërinë gjinore në trajtimin e dhunës në bazë gjinore.

5. Sigurimi i fondeve të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për strehimoret dhe shërbimet mbështetëse për të përmbushur kërkesën në rritje dhe për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për të mbijetuarat.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

355.58-055.2(496.51)(047)

Hasani, Adelina

Women’s Security Concerns in Kosovo / Adelina Hasani, Vesa Kroçi. -
Prishtinë : QKSS, 2024. -12 f. : ilustr. ; 26 cm.

1. Kroçi, Vesa

ISBN 978-9951-842-23-5

Vërejtje: Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe jo domosdoshmërisht përfaqëson pikëpamjet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.



Rreth QKSS

E themeluar në prill të vitit 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë e specializuar dhe e pavarur joqeveritare. Qëllimi primar i QKSS është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën kërkimore dhe avokuese në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë duke mbështetur programet e këtij sektori përmes hulumtimeve, eventeve, trajnimeve, avokimit dhe këshillave të drejtpërdrejta për politikë-bërësit.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon raporte të shumta, analiza të politikave dhe përmbledhje të politikave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. QKSS gjithashtu organizon më shumë se 200 ngjarje publike duke përfshirë konferenca, tryeza dhe debate, ligjërata në Kosovë, ku një pjesë e tyre organizohen në bashkëpunim me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Një gamë e gjerë aktivitetesh përfshijnë hulumtimin, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin. Puna e QKSS-së mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë por pa u kufizuar në: reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar, politikën e jashtme dhe bashkëpunimi rajonal, dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Këtë vit QKSS shënoi 15 vjetorin e themelimit. Për më tepër detaje rreth QKSS, mund të referoheni tek:



www.qkss.org

www.securitybarometer.qkss.org



@KCSSQKSS

#KCSSQKSS

ISBN 978-9951-842-23-5



9 789951 842235